

## **Historiku i krijimit të Fakultetit**

Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike është ndër fakultetet më të rinj të Universitetit Politeknik të Tiranë. Përpjekjet për krijimin e këtij fakulteti datojnë në tetor të vitit 2004, ku më urdhër të Rektorit Prof. Përparim Hoxha, ngrihet një grup punë të kryesuar nga Prof. Dr. Shpëtim LEKA dhe ku bënin pjesë, Prof. Dr. Lumturi KAPLLANI, Prof. Dr. Tatjana MULAJ, Prof. Asoc. Engjëllushe LUZI, Prof. Dr. Shpëtim SHEHU, Prof. Dr. Lulzim HANELLI dhe Prof. Asoc. Petrit BERHAMI, të cilët propozuan hapjen e dy diplomave të reja ndërdisiplinore, përkatësisht: *Inxhinieri Matematike*, pranë Departamentit të Matematikës dhe Informatikës dhe *Inxhinieri Fizike*, pranë Departamentit të Fizikës.

Ky propozim u miratua nga Senati i UPT-së, në Vendimin Nr. 17, datë 04.05.2005 dhe më pas nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Z. Luan MEMUSHI, në shkresën me Nr. 5354 Prot., e 5355, datë 22.08.2005.

Kështu, në vitin akademik 2005-2006, filluan për herë të parë përkatësisht pranë:

- *Departamentit të Matematikës dhe Informatikës*, me 32 pedagogë të brendshëm dhe 26 të jashtëm, *Kursi i Studimeve të Ciklit të Parë*, me kohëzgjatje 3-vjeçare, *Inxhinieri Matematike*, me 31 studentë;
- *Departamentit të Fizikës*, me 16 pedagogë të brendshëm dhe 32 të jashtëm, *Kursi i Studimeve të Ciklit të Parë*, me kohëzgjatje 3-vjeçare, *Inxhinieri Fizike*, me 30 studentë.

Në përputhje me strategjinë e UPT-së, që përfshin mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, sigurimin e shërbimeve si dhe plotësimin e nevojave të studentëve të UPT-së, si dhe në kuadër të implemetimit të Deklaratës së Bolonjes, krahas përgatitjeve që synonin organizime të reja bashkëkohore të kurrikulave, ishte më se e domosdoshme edhe riorganizimi i fakulteteve të vetë UPT-së.

Në vitin 2006, grupi i zgjeruar i punës, që tashmë kishte në përbërje edhe drejtuesit e fakulteteve të Inxhinierisë Mekanike, Inxhinierisë Elektrike, Inxhinierisë së Gjeologji-Minierave, Inxhinierisë së Ndërtimit, si dhe kancelaren e UPT, propozoi: *Hapjen e Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike në Universitetin Politeknik të Tiranës.*

me mision:

- përgatitjen në këto dy fusha të inxhinierëve cilësorë, të aftë për t'u integruar në tregun specifik të punës (të brendshëm dhe të jashtëm);
- mbulimin e ngarkesës mësimore në të gjitha disiplinat matematike dhe fizike për Universitetin Politenik.

Ky propozim u miratua nga Senati i UPT-së, me Vendimin Nr. 6, datë 03.03.2006.

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 824, datë 05.12.2007, miratohet krijimi i *Fakultetit të Formimit të Përgjithshëm*, si fakultet i asociuar, në përbërje të të cilit përfshihen: *Departamenti i Fizikës dhe Kimisë; Departament i Matematikës, si dhe Qendra e Gjuhëve të Huaja*, duke konsideruar diplomat e Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike si diploma ndërdisipinore.

*Dekane e parë* e këtij Fakulteti emërohet *Prof. Dr. Tatjana MULAJ*.

Por emërtimi, *Fakultet i Formimit të Përgjithshëm*, dhe statusi i dhënë këtij fakultetit nuk përputheshim me vizionin e grupit të punës dhe misionin për të cilin u propozua krijimi i *Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike*.

Dekanati, Këshilli dhe stafi akademik i Fakultetit, të mbështetur nga studentët, si dhe nga Rektorati i UPT-së, gjatë periudhës janar 2008 – prill 2009, me shkresa zyrtare si dhe takime të vazhdueshme edhe në instancat më të larta shtetërore, duke argumentuar se FFP, si fakultet i asociuar, e kishte të pamundur të realizonte misionin e përgatitjes të inxhinierëve cilësorë në fushat e inxhinierisë matematike dhe inxhinierisë fizike, të aftë për t'u integruar në tregun specifik të punës (të brendshëm dhe të jashtëm), ka kërkuar:

Të ndryshojë statusi dhe emërtimi i Fakultetit të Formimit të Përgjithshëm.

Përpjekjet këmbëngulëse, të vazhdueshme, të drejta dhe argumentuese të Dekanatit, Këshillit dhe stafit akademik të Fakultetit, u kurorëzuan me daljen e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 345, datë 08.04.2009 ku miratohet ***Krijimi i Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike***, që ka në përbërje:

- i. Departamentin e Inxhinierisë Matematike;*
- ii. Departamentin e Inxhinierisë Fizike;*
- iii. Departamentin e Kimisë;*
- iv. Qendrën e Gjuhëve të Huaja*

me dy diploma në *Inxhinieri Matematike* dhe *Inxhinieri Fizike*.

Dekan i Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike zgjidhet Prof. Dr. Shpëtim LEKA.

Pesoneli akademik i FIMIF, duke u bazuar në përvojën e Universiteteve Politeknike të vendeve të tjera, veçanërisht të Universitetit Politeknik të Milanos e Torinos, si dhe në përvojën dhe kuafikimin e anëtarëve të stafit akademik, është anagazhuar gjatë viteve në vijim për plotësimin e misionit të këtij fakulteti për *përgatitjen e*

*inxhinierëve cilësorë në të dy fushat e saj të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, të aftë për t'u integruar në tregun specifik të punës.*

Për realizimin e këtij misioni ishte i domosdoshëm thellimi i njohurive të fituara në ciklin e parë, nëpërmjet programeve të studimit të Ciklit të Dytë *Master i Shkencave* dhe të Ciklit të Tretë *Doktoraturë*. Këto programe synonin përgatitjen e inxhinierëve cilësorë me formim ndërdisiplinor, të aftë për t'u përballur me probleme që përdorin metodologji dhe mjete të ofruara nga sektorë të ndryshëm të Matematikës së Aplikuar si dhe të gatshëm për të përballuar futjen e teknologjive të reja dhe komplekse, duke shfrytëzuar në mënyrë inxhinierike metodologjitë që ofrojnë sektorët e ndryshëm të Fizikës së Zbatuar.

Kështu, bazuar në VKM-në, Nr. 910, datë 26.08.2009, nisi në vitin akademik 2009-2010 rrugëtimi i programeve të Studimit të Ciklit të Dytë:

- *Master i Shkencave në Inxhinieri Matematike*, me 21 studentë
- *Master i Shkencave në Inxhinieri Fizike*, me 18 studentë.

Në zbatim të Urdhërit, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Z. Myqerem Tafaj, Nr. 605, datë 29.12.2010, filluan në vitin akademik 2010-2011, Programet e Studimit të Ciklit të Tretë:

- *Doktoraturë në Inxhinieri Matematike* (në dy drejtime; *Analizë Numerike dhe Ekuacione diferenciale / Kërkime Operacionale dhe Statistikë*), me 17 studentë.
- *Doktoraturë Inxhinieri Fizike* (në dy drejtime; *Optikë e zbatuar / Fizika e Materialeve*), me 11 studentë.

Studimet e Ciklit të tretë synonin përgatitjen e mëtjeshme nga ana shkencore në fushën e Analizës numerike dhe Ekuacioneve Diferenciale, të Kërkimeve Operacionale dhe Statistikë, si dhe në fushën e Optikës së Zbatuar dhe të Fizikës së Materialeve.

Duke patur parasysh nevojat e reja të tregut të punës si dhe mungesën e profesionistëve, të aftë të përballen me koncepte bashkëkohore, si dhe me zgjidhjen e problemeve që lidhen, ndër të tjera, me menaxhimin e sistemeve komplekse; trajtimet klinike dhe kontrollin e cilësisë së pajisjeve mjekësore; analizën e pasojave financiare të riskut, nëpërmjet matematikës, statistikës dhe teorive financiare, u hartuan programet e Studimit të Ciklit të Dytë *Master Profesional* në:

- *Inxhinieri Matematike në Analiza Sistemesh*
- *Inxhinieri Fizike në Mjekësi*
- *Inxhinieri Matematike Profili Aktuaristikë*

Në vitin akademik 2012-2013, filluan Programet e Studimit të Ciklit të Dytë

- *Master Profesional në Inxhinieri Matematike në Analiza Sistemesh* me 14 studentë
- *Master Profesional në Inxhinieri Fizike në Mjekësi* me 12 studentë.

ndërsa në vitin akademik 2015-2016, filloi Programi i Studimit të Ciklit të Dytë,

- *Master Profesional në Inxhinieri Matematike Profili Aktuaristikë* me 28 studentë.

Gjatë këtyre viteve stafi akademik ka punuar me përkushtim për transmetimin tek studentët të një informacioni sa më cilësor e bashkëkohor në të gjitha disiplinat mësimore e lëndët me karakter të theksuar praktik, duke realizuar ciklin *informacion-njohuri-dije-aftësi*.

Krahas mësimdhënies, një prej dimensioneve të rëndësishme në FIMIF është **kërkimi shkencor** në përputhje me filozofinë dhe misionin e UPT-së, në përputhje me interesat e universitetit, të stafit akademik dhe të studentëve.

Veprimtaria mësimore dhe kërkimore në fakultet është realizuar si nëpërmjet bashkëpunimit me Institucionet e Arsimit të Lartë brenda dhe jashtë vendit, me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale dhe komunitetin e biznesit, ashtu edhe nëpërmjet **projekteve** kombëtare dhe ndërkombëtare

Sot **personeli akademik** i fakultetit përbëhet nga **22 anëtarë** që i përkasin kategorisë **Profesorë** (me tituj akademik *Profesor, Profesor i Asociuar*), **39 anëtarë** të kategorisë **Lektor** (me gradë shkencor *Doktor*), **10 anëtarë** të kategorisë **Asistent - Lektor** (me diplomë *Master i Shkencave*).

FIMIF gjatë këtyre viteve është drejtuar nga Dekani i Fakultetit, i mbështetur nga zëvendës dekan si dhe drejtuesit e departamenteve:

▪ **Dekani Fakultetit**

Prof. Dr. Tatjana MULAJ	2007 - 2009
Prof. Dr. Shpëtim LEKA	2009 - 2014
Prof. Asc. Ligor NIKOLLA	2014 - 2020
Prof. Dr. Shkëlqim KUKA	2020

▪ **Zëvendës Dekan i Fakultetit**

Prof. Asc. Ligor NIKOLLA	2007 - 2009
Prof. Dr. Tatjana MULAJ	2009 - 2014
Prof. Asoc. Dhurata KUQI	2014 në vazhdim
Prof. Asoc. Valbona LAME (MUDA)	2020

▪ ***Drejtues i Departamentit të Matematikës / Inxhinierisë Matematike:***

Prof. Dr. Shpëtim LEKA	2008 – 2009
Prof. Asoc. Ligor NIKOLLA	2009 – 2014
Dr: Adrian NAÇO	2014 - 2016
Prof. Dr. Shkëlqim KUKA	2016 – 2020
Prof. Dr. Luella PRIFTI	2020

▪ ***Drejtues i Departamentit të Fizikës dhe Kimisë***

Prof. Dr. Pëllumb BERBERI	2008 - 2009
Prof. Asoc. Petrit BERHAMI	2009

▪ ***Drejtues i Departamentit të Inxhinierisë Fizike***

Prof. Asoc. Petrit BERHAMI	2009
Prof. Asoc. Dhurata KUQI	2009 – 2013
Prof. Dr. Partizan MALKAJ	2013 – 2020
Prof. Asoc. Altin GJEVORI	2020

▪ ***Drejtues i Departamentit të Kimisë***

Prof. Asoc. Rajmonda LILO	2009 - 2020
Prof. Asoc. Edlira BARAJ	2020

▪ ***Drejtues i Qendrës së Gjuhëve të Huaja***

Prof. Asoc. Fatmir VRAPI	2008 në vazhdim
--------------------------	-----------------